

RAPORT I
PERFORMANCËS SË
KOMUNAVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
JANAR – DHJETOR 2022

Kuvendi i Komunës së Rahovecit miraton Planin Zhvillimor Komunal 2023 - 2031



Në seancë të jashtëzakonshme, Kuvendi Komunal njëzëri miratoi dokumentin strategjik më të rëndësishëm për Komunën e Rahovecit, Planin Zhvillimor Komunal 2023 – 2031.

Me këtë plan janë paraparë zgjerimi i zonave ndërtimore, i zonave të kombinuara për biznes (ndërtim dhe zonat për biznese), si dhe ruajtja e zonave bujqësore.

Mbështeten 19 biznese nga Komuna e Rahovecit

U nënshkruan marrëveshjet e subvencionimit me 19 biznese përfituese nga thirrja e lansuar nga Drejtoria për Ekonomi, Turizëm dhe Zhvillim.

Nga kjo thirrje kanë përfituar 11 biznese artizanale që menaxhohen nga gratë, 2 biznese përpunuese të ushqimit dhe 6 metalpunues.



Filluan punimet për ndërtimin e terrenit sportiv në Krushë të Madhe



Fusha sportive do të jetë me standarde bashkëkohore, për futboll, basketboll, volejbol dhe hendboll, me dimensione 40x20m, ku përfshihen rrethojat, ndriçimi dhe goma nga tartani.

Kjo fushë sportive do të shfrytëzohet nga nxënësit e ShFMU "Bajram Curri" dhe nga të rinjtë e fshatit.

Bëhet përrurimi i shtratit të përroit dhe i parkut në Gur të Kuq

